



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agencija za Zastitu Licnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DRZAVNA AGENCIJA ZA ZASTITU LICNIH PODATAKA NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIJA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE			
Njesia Org. Org. Jechn. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	6
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	03	Data Datum Date	10, 01, 2013
PRISHTINË/A			

DATË/A:	10/01/2013
REFERENC-Ë:	/2013
PËR/ZA/TO:	z. Armend Kumnova, Zyrtar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, TEB sh.a.
NGA/OD/FROM:	z. Ruzhdi Jashari, Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror - Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesa për lejimin e autorizimit për transferimin e të dhënave personale në emër të TEB Sh.A.

I nderuar z. Kumnova,

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bazë të autorizimeve dhe përgjegjësive që burojnë nga Ligji 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe pas kërkesës së Bankës TEB Sh.A për lejimin e transferimit të të dhënave personale në **Bank Soft** dhe **E-KART** me seli në Republikën e Turqisë me qëllim të personalizimit dhe shtypjes së kartelave bankare të klientëve, pas analizimit të dokumentacionit të prezantuar, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2012 të Këshillit të Agjencisë, dhe duke u bazuar në nenin 30, dhe nenin 57 (paragrafi 1 dhe 2) të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, miratojë kërkesën për dhënien e autorizimit për transferimin e të dhënave personale në emër të TEB sh.a.

Të bashkangjitur gjeni Vendimin për dhënien e autorizimit për transferiminë e të dhënave personale në emër të TEB sh.a.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agencija za Zastitu Lичnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr.02/16

Datë:21.12.2012

Në mbështetje të nenit 30, nenit 57 (paragrafi 1 dhe 2) të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 7 (paragrafi 9) i Rregullores së Punës Nr.20/2011 të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur më 21.12.2012,mori:

V E N D I M


1. Miratohen kërkesa për lejimin e autorizimit për transferimin e të dhënave personale në emër të TEB Sh.A.
2. Transferimi i këtyre të dhënave bëhet sipas dispozitave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bazë të autorizimeve dhe përgjegjësiqe që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe pas kërkesës së Bankës TEB Sh.A për lejimin e transferimit të të dhënave personale në Bank Soft dhe E-KART me seli në Republikën e Turqisë me qëllim të personalizimit dhe shtypjes së kartelave bankare të klientëve, pas analizimit të dokumentacionit të prezantuar shqyrtoi dhe vendosi si në dispozitiv.

Në kërkesë është ofruar kontrata e përgatitur në mes të Bankës TEB Sh.A dhe Bank Soft dhe E-KART, pas analizimit të kontratës së prezantuar nga banka TEB Sh.A Agjencia konstatoi se kjo kontratë për transferimin e të dhënave personale i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara sipas nenit 57 (paragrafi 2).

Agjencia e autorizon Bankën TEB Sh.A për transferimin e të dhënave personale, duke përfshirë kategoritë e të dhënave, qëllimin e transferimit dhe masat mbrojtëse në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në vendin tjetër apo organizatën ndërkombëtare.

Ruzhdi JASHARI

Mbikëqytës Kryesor Shtetëror

Vendimi i dërgohet:

- Bankës TEB Sh.A.
- Anëtarëve të Këshillit
- Drejtorëve të Departamenteve
- Arkivit të Agjencisë